



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seancë e jashtëzakonshme
SP-036
Prishtinë, më 28. 06. 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2018**

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, me rend dite:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare njëzëri janë pajtuar që shqyrtimi i projektligjit të bëhet me procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit, si dhe është vendosur që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 28 qershor 2018, në orën 10:00, me rend ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ndërsa shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të bëhet në një seancë tjetër, dikur pasdite.

Komisioni Funkcional për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nuk e ka radhitur për shqyrtim në parim projektligjin.

Ai propozoi që të jepet pauzë një orë që të ngarkohet Komisioni Funkcional për Legjislacion për shqyrtimin e projektligjit në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetarja e Komisionit për Legjislacion, Albulena Haxhiu, tha se në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar për procedimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar, dhe përkundër instistimit të anëtarit nga radhët e GP të PDK-së, komisioni nuk ka pranuar që ta trajtojë me procedura të përshpejtuar, për faktin se sipas diskutimeve, ky është projektligj tepër i rëndësishëm.

Andaj, e kemi kundërshtuar pa u lëshuar në përmbajtje të projektligjit. Komisioni nuk ka punë më, sepse nuk ka pranuar ta trajtojë këtë projektligj në procedurë të përshpejtuar.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, e paraqiti dhe e arsyetoi nevojën për shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me procedura të përshpejtuar. Diskutimi i plotë është dhënë në transkript.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se është në interes të vendit që Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të shqyrtohet me procedura të përshpejtuar. Diskutimi i plotë është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi kërkoi deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare në lidhje me këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit diskutuan: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Frashër Krasniqi, në emër të GP të PSD-së; Shkumbin Demaliaj në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; si dhe deputetët Kujtim Shala, Hajdar Beqaj, Albulena Haxhiu, Bilall Sherifi, Dardan Molliqaj, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Vjosa Osmani, Sami Kurteshi, Teuta Haxhiu, Islam Pacolli, si dhe kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, propozoi që në seancën e radhës të futet në rend dite për shqyrtim Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Por, para se të radhitet projektligji për seancë plenare, brenda muajit korrik, ministria do të bashkëpunojë me Komisionin Funkcional për Legjislacion dhe me deputetët e interesuar për këtë projektligj dhe u shpreh se janë të gatshëm t'i pranojnë propozimet e tyre në amendamentimin e këtij projektligji.

Kryesuesi konstatoi se propozimi i ministrit Abelard Tahiri është i pranueshëm për të gjitha grupet parlamentare.

Seanca e radhës, në të cilën do të shqyrtohet në parim Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të jetë më 9 korrik 2018, ndërsa për shqyrtimin e dytë të tij do të vendosë Kryesia, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryesuesi e mbylli këtë seancë në orën 12:40 minuta.

Kryesuesi i seancës:

Xhavit Haliti

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*